

Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

Prishtinë, mars 2024

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË OSK-SË

Të nderuar kolegë anëtarë të Kuvendit të OSK-së,

Kam nderin që të paraqes para juve raportin vjetor të punës për vitin 2023, sipas programit mandatues, të prezantuar në Mbledhjen Konstituive të Kuvendit të III-të të Odës së Stomatologëve të Kosovës, mbajtur me 07.04.2023. Një raport ky gjithëpërfshirës, që përfshin zhvillimet më të rëndësishme në Odën e Stomatologëve të Kosovës duke përfshirë punën e të gjitha organeve të OSK-së.

Viti 2023, ka qene viti i fundit i mandatit katër vjeçar të Kuvendit të II-rë të OSK-së, gjithashtu vit zgjedhor ku të gjithë bashkërisht kemi qenë pjesë e zgjedhjeve të Kuvendit të sotëm.

Krahas punës dhe angazhimeve nga detyra e të parit të OSK-së, me bashkëpunim të ndërsjellët, me mirëkuptim dhe punë të palodhur ne kemi arritur që gjatë kësaj periudhe njëvjeçare të realizojmë me sukses objektivat e parapara sipas planit të punës.

Prandaj, shfrytëzoj rastin që t'ju falenderoj për angazhimin, mbështetjen dhe përkrahjen të parezervë dhënë Odës së Stomatologëve të Kosovës.

Me respekt,


Prof. Dr. Blerim Kamberi

Kryetari i Odës së Stomatologëve të Kosovës

PËRMBAJTJA

<i>Hyrje</i>	3
<i>Zgjedhja e Organeve të OSK-së</i>	4
<i>Vazhdimësia e transparencës dhe llogaridhënia për punën e organeve të Odës</i>	4
<i>Azhurnimi në baza mujore i regjistrit të anëtarësisë dhe regjistrit të licencave të stomatologëve</i>	5
<i>Plotësim / ndryshimi i akteve juridike të OSK-së</i>	5
<i>Puna e organeve dhe komisioneve të përbërshme të Odës</i>	5
<i>Regjistrimi, licencimi dhe rilicencimi i stomatologëve</i>	6
<i>Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP)</i>	8
<i>Çështjet etike</i>	16
<i>Komisioni për buxhet dhe financa</i>	17
<i>Solidariteti dhe ndihma reciproke</i>	17
<i>Memorandumet e bashkëpunimit</i>	18
<i>Aktivitetet tjera</i>	20
<i>Raporti i pasqyrave financiare</i>	26

HYRJE

Oda e Stomatologëve të Kosovës në përputhje me mandatin e saj ligjor të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Statutit të OSK-së, si dhe planit vjetor të punës, ka realizuar aktivitetet e planifikuara gjatë vitit 2023. Raporti në vijim pasqyron arritjet sipas fushave të përcaktuara që njëherit kanë qenë të përfshira në planin vjetor të punës së OSK-së.

Në vijim janë paraqitur objektivat të cilat kanë qenë të planifikuara për vitin 2023..

- Zgjedhja e organeve të OSK-së,
- Vazhdimësia e transparencës dhe llogaridhënja për punën e Odës,
- Asistenca në zhvillimin e mëtejshëm dhe zbatimin e kapacitetit të EVP-së dhe në regjistrimin, licencimin/rilicencimin e stomatologëve,
- Azhurnimi në baza mujore i regjstrit të anëtarësisë dhe regjstrit të licencave të stomatologëve si dhe lëshimin e faksimileve unike,
- Plotësim /ndryshimi i akteve juridike të OSK-së,
- Sigurimi i stabilitetit financiar i OSK,
- Mbajtja e ligjëratave profesionale në kuadër të EVP-s për vitin 2023 në 7 (shtatë) Qendra Rajonale të Kosovës.
- Mbrojtja e interesave profesionale, konsulta, informacione dhe shërbime të tjera për anëtarët e Odës,
- Organizimi i punëtorive dhe tryezave profesionale me qëllim të identifikimit të problemeve, shqetësimeve të komunitetit të stomatologëve si dhe ngritjes së nivelit të tyre profesional,
- Mbështetja financiare për anëtarët e Odës në rastet e sëmundjeve të rënda nga fondi i veçantë i solidaritetit dhe ndihmës reciproke,
- Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e ndryshme vendore dhe rajonale
- Bashkëpunimi me odat tjera të profesionistëve shëndetësor,
- Vazhdimësia e bashkëpunimit me FDI dhe European Regional Organization (ERO),
- Auditimi financiar dhe funksional për vitin 2022.

1. ZGJEDHJA E ORGANEVE TË OSK-SË

Më 7 Prill 2023 u mbajt mbledhja konstituive e Kuvendit të III-të të Odës së Stomatologëve të Kosovës, në të cilën u bë zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarëve të OSK-së, Ndërsa me datë 4 maj dhe 8 Qershor 2023 u zgjodhën edhe organet tjera të OSK-së.



2. VAZHDIMËSIA E TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIA PËR PUNËN E ORGANEVE TË ODËS

Në vazhdimësi është ngritur transparenca dhe llogaridhënia për punën e të gjitha organeve të OSK-së nëpërmjet Web-faqes së Odës si mjet për realizimin e këtij objekti. Janë publikuar të gjitha informatat rreth punës së organeve të Odës, vendime dhe çështje tjera relevante të përditësuara në baza të rregullta, që janë me rëndësi për komunitetin e stomatologëve të vendit, e të cilat do të nxisin në vazhdimësi llogaridhënien dhe transparencën e punës së organeve të Odës.

3. AZHURNIMI NË BAZA MUJORE I REGJSITRIT TË ANËTARËSISË DHE REGJISTRIT TË LICENCAVE TË STOMATOLOGËVE

Në baza mujore është bërë përditësimi i regjistrit të anëtarësisë dhe regjistrit të licencave valide të stomatologëve në nivel vendi në Webfaqen zyrtare të Odës.

Deri në ditën e raportimit të punës sonë njëvjeçare, Oda e Stomatologëve të Kosovës numëron 2493 anëtarë të anëtarësuar në odë dhe 2361 stomatolog me licencë valide të punës.

4. PLOTËSIM /NDRYSHIMI I AKTEVE JURIDIKE TË OSK-SË

Gjatë vitit 2023 është bërë plotësim/ndryshimi i këtyre akteve normative:

- Rregullore për Regjistrim, Licencim/Rilicencim të stomatologëve;
- Rregullore për Edukim të Vazhdueshëm Profesional;
- Rregullore për menaxhimin e financave të OSK-së;
- Rregullore për procedurat e prokurimit;
- Rregullore për dhënien e dekoratave dhe çmimit vjetor

5. PUNA E ORGANEVE DHE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË ODËS

KUVENDI I OSK-SË gjatë vitit 2023 ka mbajtur katër mbledhje.

Është bërë konstituimi i legjislaturës së III-të të Kuvendit të OSK-së si dhe zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarëve, konstituimi i organeve dhe komisioneve të përherëshme të OSK-së; Është miratuar projekt-buxhetit i OSK-së për vitin 2023; Marrëveshja e zbatimit të projektit për ndërtimin e objektit të përbashkët të OPSH-ve; Janë miratuar Rregullore për regjistrim, licencim/rilicencim të stomatologëve; Rregullore për edukim të vazhdueshëm profesional; Rregullore për menaxhimin e financave; Rregullore për procedurat e prokurimit dhe Rregullore për dhënien e dekoratave dhe çmimit vjetor.

KËSHILLI DREJTUES ka mbajtur 10 (dhjetë mbledhje) me ç'rast janë marrë vendime të ndryshme, disa nga to po i përmendim si në vijim:

- Vendim për formimin e Komisionit Zgjedhor;
- Miratimi i raportit financiar për periudhën 01.10.2022-31.12.2022;



- Shpallja e konkursit për mbështetje financiare të pesë (5) punimeve shkencore;
- Miratimi i raportit përmbledhës së punës së OSK-së për vitet 2019 – 2022;
- Emërimi i Sekretariatit të KQZ, anëtarëve të KNJZ dhe kompenzimi i tyre;
- Zgjedhja e Kryesuesit të KD-së dhe Zv. Kryesuesit;
- Propozim për përbërjen e Komisioneve;
- Miratimi në parim draft marrëveshjes për ndërtimin e objektit të përbashkët të OPSH-ve;
- Miratimi propozim – projekt buxheti i OSK-së për vitin 2023;
- Miratimi i propozimit për planin e punës së OSK-së për vitin 2023;
- Miratimi i raporteve të punës Janar - Qershor 2023;
- Miratimi i raportit financiar për periudhën 01.01.2023 – 30.06.2023;
- Miratimi i draft rregullore për EVP dhe draft rregullorja për dhënien e dekoratave dhe çmimit vjetor;
- Vendim për depozitimin e mjeteve financiare të OSK për periudhën 24 mujore;
- Miratimi i draft rregullore për regjistrimin, licencimin dhe rilicencimin e stomatologëve; draft rregullore për menaxhimin e financave dhe draft rregullore për procedurat e prokurimit;
- Miratohet raporti financiar për periudhën 01.07.2023 – 30.09.2023;
- Vendim mbi lartësinë pagave, shtesave funksionale, mëditjeve të organeve të OSK-së dhe shpenzimeve tjera;
- Miratimi projekt buxheti për vitin 2024;

REGJISTRIMI, LICENCIMI DHE RILICENCIMI I STOMATOLOGËVE

Komisioni për Regjistrim, Licencim/Rilicencim të Stomatologëve ka kryer procedurat ligjore të anëtarësimit, licencimit dhe rilicencimit të stomatologëve.

Gjatë vitit 2023 janë:

- a. Anëtarësim **250** stomatolog,
- b. Licencim- Doktor i Stomatologjisë **237** dhe licencim specialistik **26**.
- c. Rilicencim - Doktor i Stomatologjisë **235** dhe Rilicencim specialistik **184**
- d. Të ç'antërasuar (në mënyrë të vullnetshme) **4** stomatologë.



EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL (EVP)

Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (KVEP) gjatë vitit 2023 ka akredituar 27 (njëzet e shtatë) evente të ndryshme dhe 3 (tre) janë refuzuar.

1. Akreditimi i Kursit “PRF, from dentistry to aesthetic”, kompanisë BHC Institute, mbajtur me datë 08.04.2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

2. Akreditimi i Kongresit “Kongresi i dytë ndërkombëtar i Stomatologjisë “Prishtina Dental Weekend” e Kolegji AAB, mbajtur me datë 05-07.05.2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 25 pikë

Pjesëmarrja pasive 20 pikë

3. Akreditimi i kursit “Pikat kyçe në marrjen e masës së saktë tek protezat me implante”, kompanisë NTP Allianz, mbajtur me datë 25.03.2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

4. Akreditimi i kursit “Përmirësoni aftësitë tuaja endodontike”, kompanisë NTP Allianz, mbajtur me datë 31 mars dhe 01 prill 2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 8 pikë

5. Akreditimi i Kursit “Program i avansuar në Implantologji-Moduli 2, e kompanisë NTP Allianz, i mbajtur me datë 24-25-26.03.2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 8 pikë

6. Akreditimi i Kursit “Radiografia në Implantologji”, kompanisë NTP Allianz, mbajtur me 05.05.2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

7. Akreditimi i seminarit “Sistemi i maskerinave FAS-Harku i vërtetë i mbylljes. Rezultate më të mira me numër më të vogël të maskerinave”, kompanisë NTP Allianz, mbajtur me datë 06.05.2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

8. Akreditimi i kursit “Menaxhimi kirurgjik indeve të buta dhe të forta”, kompanisë Aseps Mediacal, i mbajtur me datë 06.05.2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

9. Akreditimi i konferencës “Dita botërore e Ortodontisë”, Shoqatës së Ortodontëve të Kosovës, mbajtur me datë 20.05.2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 15 pikë

Pjesëmarrja pasive 10 pikë

10. Akreditimi i kursit “Protokolli restaurues para terapise protetike”, organizuar nga kompania NTP Allianz, mbajtur me datë 19.05.2023, në Prishinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

11. Akreditimi i kursit “Preparimi dhe cementimi i restaurimeve pa permbajtje metali tek dhembet natyral dhe tek implantet”, organizuar nga kompania NTP Allianz, mbajtur me datë 19.05.2023, në Prishinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

12. Akreditimi i kursit “Restaurimet direkte me kompozite IPS Empress Direct ne praktiken e perditshme”, organizuar nga kompania NTP Allianz, mbajtur me datë 20.05.2023, në Prishinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

13. Akreditimi i kursit “Competence in Estetics”, organizuar nga kompania NTP Allianz, i mbajtur me datë 20.05.2023, në Prishinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

14. Akreditimi i kursit “Implantologjia prej A deri Z sipas standarteve të Asociacionit Europiant te Osteointegrimit”, organizuar nga kompania NTP Allianz, mbajtur me datë 26-27.05.2023, në Prishinë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 8 pikë

15. Akreditimi i kongresit “Kongresi Ndërkombetar i kirurgëve oral dhe maksillofacial të ballkanit”, organizuar nga shoqata e kirurgëve maksillofacial dhe oral të Kosovës, mbajtur me datë 06-07-08.10.2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 25 pikë

Pjesëmarrja pasive 20 pikë

16. Akreditimi i kursit “Përdorimi i seacionit koshient N₂O në praktikën stomatologjike”, organizuar nga kompania Ana Pharmaceuticals, mbajtrr me datë 23-24.06.2023, në Prishinë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 8 pikë

17. Akreditimi i konferencës “Konferenca e dytë e Shoqatës së Endodontëve të Kosovës me pjesëmarrje ndërkombëtare”, Shoqatës së Endodontëve të Kosovës dhe Oda e Stomatologëve të Kosovës, mbajtur me datë 22-23.09.2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 15 pikë

Pjesëmarrja pasive 10 pikë

18. Akreditimi i kursit “Menaxhimi i emergjencave ne stomatologji/Basil Life Support”, organizuar nga kompania Ana Pharmaceuticals, mbajtur me datë 23.09.2023, në Prishinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

19. Akreditimi i kursit “Marrja e vendimeve për përzgjedhjen ideale të abutmentit të implanteve”, kompanisë NTP Allianz, mbajtur me datë 13.10.2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

20. Akreditimi i kursit “Pikat kyçe në marrjen e masës së saktë tek protezat me implante”, e kompanisë NTP Allianz, i mbajtur me datë 14.10.2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

21. Akreditimi i kursit “Zoterimi i terapise se kanalit te rrenjes me qasje moderne”, organizuar nga NTP Allianz, mbajtur me 20-21.10.2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 9 pikë

Pjesëmarrja pasive 8 pikë

22. Akreditimi i kursit “What is Laser? All possible clinical indications of semiconductor diode laser.Theoratical and practical one day course”, të organizuar nga Ana Pharmaceuticals, mbajtur me datë 04.11.2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 6 pikë

Pjesëmarrja pasive 5 pikë

23. Akreditimi i konferencës “Konferenca e tretë e Shoqatës së stomatologjisë pediatrike dhe preventive të Kosovës-me pjesëmarrje ndërkombëtare”, organizuar nga Shoqata e stomtologjisë pediatrike dhe preventive të Kosovës dhe Odës së Stomatologëve të Kosovës, mbajtur me datë 08-09.12.2023, në Prishtinë.

Pjesëmarrja aktive 20 pikë

Pjesëmarrja pasive 15 pikë

24. Akreditimi i konferencës “Konferenca ndërkombëtare e Shkencave Stomatologjike”
organizuar nga Institucioni i Edukimit të Lartë UBT, mbajtur me datë 28-29.10.2023, në Prishtinë.
Pjesëmarrja aktive 20 pikë
Pjesëmarrja pasive 15 pikë
25. Akreditimi i ligjeratave profesionale “Efekti i cigareve elektronike (vape) ne shendetin oral”,
të organizuar nga Fakulteti i Mjekesise dhe Oda e Stomatologeve te Kosoves (ligjeratat
profesionale do të mbahen gjatë muajit janar-mars 2024).
Pjesëmarrja aktive 8 pikë
Pjesëmarrja pasive 5 pikë
26. Akreditimi i Kursit “Program i avansuar në Implantologji-Moduli 1, kompanisë NTP
Allianz, mbajtur me datë 16-17.12.2023, në Prishtinë.
Pjesëmarrja aktive 9 pikë
Pjesëmarrja pasive 8 pikë
27. Akreditimi i Kursit “Program i avansuar në Implantologji-Moduli 2, kompanisë NTP
Allianz, (kursi do të mbahet me datë 20-21.01.2024, në Prishtinë).
Pjesëmarrja aktive 9 pikë
Pjesëmarrja pasive 8 pikë
28. Është shqyrtuar kërkesa për akreditim të kursit “Përdorimi i sedacionit në praktikën dentare”
që do të mbahej në Klinikën DRD Dental Pejë, dhe Advanced Dental Center Prishtinë, të
organizuar nga Ana Pharmaceuticals dhe komisioni vendosi që të merret leja për hulumtim
bio mjekësor meqenëse pjesa praktike do të bëhet në njerëz.
Meqenëse aplikuesi nuk ka kompletuar dokumentet tek komisioni për çështje etike dhe nuk
ka marr lejen nga komisioni, KEVP nuk akrediton eventet në fjalë.
- Gjatë vitit 2023, KEVP ka lëshuar **410** Certifikata/vërtetime mbi valorizimin e pikëve kredituese të anëtarëve të saj si dëshmi se plotësojnë kushtet për rilicencimin e tyre, ndërsa **10** raste janë refuzuar për mungesë të pikëve kredituese jo të mjaftueshme.

- **Realizimi i plan-programit të ligjëratave profesionale në kuadër të EVP-së për vitin 2023 në 7 (shtatë) rajone të Kosovës**

Janë organizuar cikle të ligjëratave profesionale me tema të ndryshme nga praktika stomatologjike. Këto ligjërata janë mbajtur nga ekspertët vendor dhe janë ndjekur nga një numër i madh i stomatologëve.



Pamje nga një ligjëratë profesionale e mbajtur në Gjakovë

Në bashkëpunim me kordinatorët për EVP, është përpiluar programi i ligjëratave profesionale dhe plani dinamik i realizimit të tyre nëpër rajonet e Kosovës (Prishtinë, Gjiatë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Ferizaj), për vitin 2024.

- **Organizimi i përbashkët i Konferencave stomatologjike me shoqatat profesionale**

Në bashkëpunim me Shoqatën e Endodontëve të Kosovës me datë 22-23 shtator 2023 është organizuar Konferenca e dytë e Endodontëve të Kosovës me pjesëmarrje ndërkombëtare, ndërsa me Shoqatën e Stomatologjisë Pediatrike dhe Preventive me datë 8-9 dhjetor 2023 është mbajtur Konferenca e tretë me pjesëmarrje ndërkombëtare. Konferencat kanë përfshirë ligjerata me ligjërues vendorë dhe ndërkombëtarë nga vendet e ndryshme. Konferencat janë ndjekur nga një numër i madh i stomatologëve.



Pamje nga Konferenca e dytë me Shoqatën e Endodontëve të Kosovës,
22-23 shtator 2023



Pamje nga Konferenca e tretë me Shoqatën e Stomatologjisë Pediatrike dhe Preventive, 8-9 dhjetor 2023 18 dhjetor 2021


- **Përkrahja financiare për autorët e punimeve shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare**

Oda e Stomatologëve të Kosovës në vazhden e aktiviteteve të saj, në lidhje me përkrahjen, zhvillimin e kapaciteteve shkencore vendore dhe me qëllim të stimulimit si dhe promovimit të shkencës të realizuar nga anëtarët e saj që janë vlerësuar dhe botuar në revistat prestigjioze kredibile me impakt ndërkombëtar, pas shpalljes së konkursit për përfitimin e granteve shkencore për punimet e publikuara përgjatë vitit 2022 ka përzgjedhur pesë (5) punime të autorëve, anëtarë të OSK-së, të cilët kanë përfituar shumën në vlerë prej 500.00 € (euro).

- **Botimi periodik i dy numrave të Revistës së Stomatologëve të Kosovës (RSK)**

Gjatë viti 2023 janë botuar dy numra të rinj të RSK, Vëllimi 2, Numri 1 (qershor) dhe Vëllimi 2, Numri 2 (dhjetor), në formën elektronike dhe të shtypur. Në këto dy numra RSK ka ofruar publikime të ndryshme profesionale e shkencore nga të gjitha disiplinat stomatologjike, në të cilat autorët ndër të tjerash kanë ndarë edhe përvojën e tyre profesionale nga praktika e përditshme stomatologjike. Secilit anëtarë të OSK-së nëpërmjet sms elektronik ju është dërguar linku për kyçjen në formën elektronike.

Në këtë vit RSK është e Indeksuar në Google Scholar dhe CrossRef. Synimi jonë është që në një të ardhme të afërme të indeksohemi edhe në platformat tjera.



ÇËSHTJET ETIKE

Në periudhën raportuese janë shqyrtuar 6 (gjashtë) raste për pretendim të shkeljes etike. Tri raste janë shqyrtuar nga Prokurori, por që nuk janë proceduar mëtutje për shkak se kanë përfunduar me aktvendim të Prokurorit. Dy raste janë proceduar në Këshilli Etik, prej të cilave në njërin rast ka shqiptuar masë disiplinore konform rregullores në fuqi dhe rastin tjetër e ka pezulluar për afat të pacaktuar. Poashtu nga Prokuroria Themelore Gjilan kemi pranuar një rast ku kanë kërkuar opinionin e ekspertave për pretendim të trajtim të pandërgjegjshëm mjekësor të një anëtari të OSK-së. Ekspertët profesional kanë shqyrtuar rastin dhe kanë konstatuar se anëtari i OSK-së nuk ka bërë trajtim të pandërgjegjshëm mjekësor.

Këshilli Etik gjatë kësaj periudhe ka lëshuar 108 vërtetime për të kaluarën etike. 55 brenda vendit dhe 53 jashtë vendit.

Komisioni Etik në periudhë njëvjeçare, ka shqyrtuar 7 raste për leje të hulumtimit bio-mjekësor, 5 raste prej tyre janë aprovuar dhe 2 janë refuzuar për mos plotësimin e dokumentacionit në tërësi dhe me kohë.

KOMISIONI PËR BUXHET DHE FINANCA

Gjatë kësaj periudhe kohore njëvjeçare, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka mbajtur katër mbledhjet e punës. Ku janë analizuar, shqyrtuar si dhe është bërë aprovimi i raporteve financiare dhe i projekt buxhetit të OSK-së, për periudhat si në vijim:

- 1) Raporti financiar 6 mujor për periudhën: 01.01.2023 – 30.06.2023,
- 2) Miratimi i draft rregullores për menaxhimin e financave, dhe
- 3) Raporti financiar 3 mujor për periudhën 01.07.2023 – 30.09.2023;
- 4) Miratimi i projekt buxhetit të OSK-së, për vitin 2024.

KOMISIONI PËR SOLIDARITETI DHE NDIHMA RECIPROKE

Në Komisionin për Solidaritet dhe Ndihme Reciproke gjatë periudhës raportuese janë paraqitur katër raste që kanë kërkuar mbështetje financiare për shkaqe shëndetësore. Komisioni i ka shqyrtuar pozitivisht dhe janë lejuar mjetet nga Këshilli Drejtues.

6. MEMORANDUMET E BASHKËPUNIMIT

- **Memorandumi i bashkëpunimit me Fakultetin e Mjekësisë**

Është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me dekanen e Fakultetit të Mjekësisë Prof.Dr. Suzana Manxhuka-Kërliu. Në këtë marrëveshje jemi zotuar edhe për projekte kërkimore të përbashkëta si dhe në botime të përbashkëta profesionale/shkencore në Revistën e Stomatologëve të Kosovës.



Pamje nga takimi në Fakultetin e Mjekësisë

- **Memorandumi i bashkëpunimit me Kolegjin AAB-Fakulteti i Stomatologjisë**

Kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimit ndërinstitucional me Kolegjin AAB-Fakulteti i Stomatologjisë. Marrëveshja ndër tjerash parasheh organizimin e aktiviteteve profesionale dhe shkencore të përbashkëta në fushën e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional duke përfshirë ligjërata, trajnime, kongrese/konferenca dhe forma tjera të avancimit profesional dhe shkencor për komunitetin tonë.



Pamje nga takimi me përfaqësues të Kolegjit AAB

- **Nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet kryetarëve të OPSH-ve për ndërtimin e ndërtesë së përbashkët**

Është nënshkruar marrëveshja ndërmjet kryetarëve të OPSH-ve për ndërtimin e ndërtesë së përbashkët, në të cilën përveç tjerash palët janë dakorduar për shfritëzimin e hapësirave për nevojat administrative të tyre. Ndarja e pronësisë është formuluar duke marr parasysh numrin e anëtarësisë dhe specifikacionit të përfaqësimit dhe fushëveprimit të secilit nga Implementuesit dhe se Implementuesit do të regjistrojnë të drejtat e tyre pronësore sipas sipërfaqës dhe pjesëmarrjes në bashkëpronësi sipas kësaj marrëveshjeje.



Pamje nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes ndërmjet kryetarëve të OPSH-ve

7. AKTIVITETET TJERA

- **Zhvillimi i platformës digjitale të shërbimeve administrative për profesionistët shëndetësorë**

Jemi në fazën përfundimtare të zhvillimit të platformës digjitale të shërbimeve administrative për anëtarësinë e saj, e cila atyre do t'i mundësojë qasje efektive on-line për të gjitha shërbimet që ofron OSK-ja. Ky projekt financohet nga LuxDev. Lansimi i kësaj platforme pritet të fillojë në vitin 2024.

- **Ndarja e parcelës për ndërtimin e objektit/ ndërtesës së përbashkët të odave të profesionistëve shëndetësorë**

Odat e profesionistëve shëndetësor do të bëhen së shpejti me ndërtesën e tyre të përbashkët, projekt ky i financuar nga LuxDev, e që pritet të fillojë realizimin në vitin 2024. Kryetarët e OPSH-ve kanë nënshkruar kontratën me kryetarin e komunës së Prishtinës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës me qëllim të ndërtimit të ndërtesës së përbashkët.



Pamje nga takimi me kryetarin e Komunës së Prishtinës

- **Takimi me Ministrin e Shëndetësisë Dr. Vitia**

Gjatë takimit kemi adresuar ndër të tjerash dokumentin mbi strategjinë e zhvillimit të stomatologjisë në nivel vendi, Opinionin/Udhëzimin profesional mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e doktorit të stomatologjisë në ofrimin e shërbimeve specifike stomatologjike si dhe mbi dokumentin Udhëzues për menaxhimin e riskut profesional në praktikën private stomatologjike.

Ministri i Shëndetësisë shprehi gadishmërinë e plotë për një bashkëpunim dhe këshillim profesional si dhe ngritjen e grupeve të përbashkëta ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Odës, për hartimin e koncept dokumenteve rreth çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me sektorin e stomatologjisë në nivel vendi.



Pamje nga takimi me ministrin Dr. Vitia

- **Takimi me Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i Kuvendit të Republikës së Kosovës**

Me Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kryetari i OSK-së ka zhvilluar një takim, në të cilin kanë qenë të ftuar kryetarët e Odave të Profesionistëve Shëndetësor. Tema për të cilën është diskutuar ka qenë: Puna dhe sfidat e Odave të Profesionistëve Shëndetësor, me ç'rast është prezentuar një përmbledhje të të arriturave dhe zhvillimit në OSK, por edhe për sfidat e saja si dhe kërkuam mbështetje të komisionit për bartjen e kompetencave ligjore që ende nuk janë bartur nga Ministria e Shëndetësisë. Poashtu janë dhënë sugjerime dhe komente në lidhje me projekt- ligjet

dhe politikat e reja që janë në proces të hartimit nga Ministria e Shëndetësisë. Komisioni shprehi mbështetjen e punës së deritanishme dhe gatishmërinë për koordinim në të ardhmen.



Pamje nga takimi me takimi me Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i Kuvendit të Republikës së Kosovës

- **Punëtorja e organizuar për hartimin e Udhëzuesit për menaxhimin e riskut profesional në praktikën private stomatologjike- Informimimi i pacientit për miratim të ndërhyrjes stomatologjike**

Me qëllim të lehtësimit të punës së anëtarëve të saj dhe shmangjes së keqkuptimeve të mundëshme mes anëtarëve të saj dhe pacientëve gjatë apo pas tretmanit stomatologjik, Oda e Stomatologëve të Kosovës, nëpërmjet të grupit të ekspertëve profesional, ka nxjerrë dokumentin: Udhëzues për menaxhimin e riskut profesional në praktikën private stomatologjike- Informimimi i pacientit për miratim të ndërhyrjes stomatologjike. Dokumenti përbëhet prej dy pjesëve:

- Udhëzuesit për marrjen e plëlqimit për trajtim stomatologjik nga pacienti dhe
- Pëlqimi për trajtim stomatologjik



Pamje nga punëtorja me grupin e ekspertëve profesional

- **Opinion për kushtet dhe procedurat për ushtrimin e veprimtarisë stomatologjike në institucionet private**

Bazuar në shqetësimin e komunitetit tonë lidhur me projekt-propozimin e udhëzimit administrativ – kushtet dhe procedurat për ushtrimin e veprimtarisë shëndetësore në institucionet private, ju është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë me opinionin e saj lidhur me këtë projekt-propozim, në të cilën kemi adresuar vërejtjet si dhe kemi dhënë sugjerimet tona bazuar në praktikatat më të mira të vendeve të zhvilluara.

- **Njoftim publik për anëtarët që përdorin tituj fiktivë**

Kemi njoftuar opinionin publik për një fenomen jo të rrallë që disa anëtarë përdorin tituj fiktivë në rrjetet e tyre sociale në mënyrë të padrejtë me qëllim të dezinformimit të qytetarëve rreth shërbimeve stomatologjike që ofrojnë, dhe atyre ju është përkujtuar se përdorimi i titujve në mënyrë të padrejtë Oda e Stomatologëve të Kosovës i kujton të gjithë anëtarët se përdorimi i titujve në mënyrë të padrejtë është një shkelje serioze e ligjit dhe kjo është e dënueshme sipas legjislacionit aktual dhe se Oda e Stomatologëve të Kosovës do të ndër marrë të gjitha hapat etik dhe ligjor për të trajtuar këto raste.

- **Takimi me grupin e ekspertët e Lux. Development**

Me ekspertët e Lux. Dev. të angazhuar për hartimin dhe dizajnimin e projektit/objektit të përbashkët të Odave të Profesionistëve Shëndetësor kemi shtjelluar çështjet që ndërlidhen me hapësirat e OSK-së në kuadër të ndërtesës së përbashkët me odat tjera, që pritet të realizohet në vitin 2024.



Pamje nga takimi me grupin e ekspertëve

- Shkresa Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për planifikim të numrit të studentëve të stomatologjise që pranohen në UP dhe Kolegjet private të arsimit të lartë.
- Pjesëmarrja e përfaqesuesit të OSK-së në komisione të ndryshme për hartimin e projektligjeve nga ana e MSH.
- Nënshkrimi me Kapital Ria për ofrimin e pagesave për anëtarët e OSK-së.

8. RAPORTI I PASQYRAVE FINANCIARE

Transparenca e shpenzimeve të parasë nëpërmjet publikimit të raporteve financiare në faqen zyrtare të OSK-së;

Është siguruar vazhdimësia e stabilitetit financiar të OSK-së;

Është bërë regjistrimi në tërësi i mjeteve kryesore dhe inventarit në përdorim dhe është futur në programin financiar ProData;

Është bërë auditimi i pasqyrave financiare dhe auditimi funksional për vitin 2022. Në auditimin financiar, auditori i jashtëm ka dhënë opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare të OSK-së. Po ashtu, në aspektin funksional të organeve të OSK-së auditori i jashtëm ka dhënë opinion të pakualifikuar dhe pa ndonjë theksim të çështjes lidhur me funksionimin e organeve të OSK-së.

Tabelat me poshtë paraqesin pasqyrimin e të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha aktivitetet e parapara në kuadër të veprimtarisë së përgjithshme të Odës, për periudhën njëvjeçare (2023). Në kategorinë e të hyrave (në llogarinë kryesore bankare dhe nënlogarinë për fondin për solidaritet) gjithsejt kanë qenë **206.452,59€**, ndërsa në kategorinë e shpenzimeve (në llogarinë kryesore bankare dhe nënlogarinë për fondin për solidaritet) janë shpenzuar gjithsejt **144.791.88€**.

RAPORT I PËRGJITHSHËM FINANCIAR
PERIUDHA RAPORTUESE 01.01.2023 – 31.12.2023

I. TË HYRAT:

1 - NË LLOGARINË KRYESORE BANKARE

1-TË HYRAT		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	REALIZIMI TM1-TM4
1	Të hyrat nga anëtarësimi	20,820.00€	59,480.00€	12,287.93€	8,930.00€	100,592.93€
2	Të hyrat nga licencimi	9,200.00€	6,500.00€	5,400.00€	5,000.00€	26,100.00€
3	Të hyrat nga rilicencimi	9,180.00€	10,100.00€	8,760.00€	9,600.00€	37,640.00€
4	Të hyrat nga EVP	3,675.00€	11,788.90€	2,240.00€	5,142.00€	22,845.90€
5	Të hyrat nga Kodi Etik	2,160.00€	480.00€	240.00€	450.00€	3,330.00€
6	Të hyrat nga shqiptimi i masave disiplinore	-	-	-	200.00€	200.00€
7	Të hyrat nga mbajtja e provimeve vlerësuese	200.00€	-	1,200.00€	1,000.00€	2,400.00€
8	Të hyrat tjera (duplikim i Licencës, ndërrim i ID,)	20.00€	5.00€	65.00€	5.00€	95.00€
9	Të hyrat nga faksimilat	810.00€	615.00€	860.00€	977.00€	3,262.00€
10	Të hyrat nga hulumtimet bio-mjekësore	150.00€	600.00€	400.00€	800.00€	1,950.00€
11	Të hyrat nga gjobat për vonesë në pagesë të anëtarësisë	540.00€	550.00€	360.00€	-	1,450.00€
12	Të hyrat nga hapësirat reklamuese për botimin e RSK	1,000.00€	-	-	-	1,000.00€
13	Bartja e mjeteve nga llog. e solidaritetit	-	-	395.83€	150.00€	545.83€
14	Pagesat gabimisht	-	-	-	75.00€	75.00€
I. GJITHSEJ të hyrat në llogarinë kryesore:						201,486.66€

2 - NË NËNLOGARINË BANKARE TË FONDIT PËR SOLIDARITET

1-TË HYRAT		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	REALIZIMI TM1:TM4
1	Të hyrat nga pagesat e gjobave për Ri-Licencim	350.10€	1,350.00€	1,350.00€	1,520.00€	4,570.10€
2	Pagesa gabimisht	-	-	395.83€	-	395.83€
II. GJITHSEJ të hyrat në nënlogarinë e fondit për solidaritet:						4,965.93€

Gjithsej të hyrat nga: Llogaria kryesore + Llogaria e Solidaritetit (I+II) **206,452.59€**

II. SHPENZIMET:

1 - SHPENZIMET NË LLOGARINË KRYESORE BANKARE

2-SHPENZIMET		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	SHPENZIM ET TM1-TM4
1	Shpenzimet për paga dhe meditje	19,650.78€	18,527.29€	15,381.25€	21,189.45€	74,748.77€
2	Tatimi në paga dhe mëditje	1,715.74€	1,595.06€	1,405.69€	2,459.26	7,175.75€
3	Kontribute pensionale	1,179.15€	786.11€	1,723.26€	2,831.34€	6,519.86€
4	Shpenzimet e faksimilave	365.70€	349.8€	429.30€	572.37€	1,717.17€
5	Qeraja dhe tatimi ne qera	1,252.74€	1,252.74€	1,252.74€	1,290.32€	5,048.54€
6	Anëtarshimi në FDI dhe ERO	644.33€	-	-	250.00€	894.33€
7	Auditimi Financiar/Funksional 2022	2,500.00€	-	-	-	2,500.00€
8	Komunale (rrymë,ujë,mbeturina,ngrohje)	54.65€	81.96€	101.38€	117.40€	355.39€
9	Administrative/Operacionale të zyres: web,materiale të ndryshme pune për zyre	1,985.13€	1,248.47€	1,169.76€	1,128.52€	5,531.88€
10	Reprezentacion, telefon dhe internet, derivate, taxi	739.86€	493.24€	766.13	1,050.15€	3,049.39€
11	Botimi i Revistës së Stomatologëve të Kosovës	-	2,487.50€	-	2,487.50€	4,975.00€

12	Angazhimi i ekspertit financiar për ofrim të shërbimeve	-	-	-	1,400.00€	1,400.00€
13	Shpenzimet e zgjedhjeve të organeve të OSK-së	-	6,927.25€	-	-	6,927.25€
14	Punëtoritë	123.50€	193.20€	-	398.30€	715.00€
15	Shpenzimet e mirëmbajtjes së webfaqes dhe programit financiar ProData	1,399.00€	-	-	300.00€	1,699.00€
16	Paisje dhe Inventar	-	235.00€	-	239.00€	474.00€
17	Përkrahje financiare për punime shkencore	2,500.00€	-	-	-	2,500.00€
18	Përkrahje financiare për botimin e librit të përkthyer me titull "Sëmundjet profesionale dhe sëmundjet që lidhen me punën e stomatologëve (AlbMed)	-	-	2,000.00€	-	2,000.00€
19	Provizione bankare	224.10€	195.10€	175.90€	245.50€	840.60€
20	Shpenzimet e kuvendit	-	-	-	1,530.00€	1,530.00€
21	Shpenzimet për ceremoninë e shënimit të 10 vjetorit të OSK-së	-	-	-	5,939.60€	5,939.60€
22	Udhëtime zyrtare	-	-	420.12€	-	420.12€
23	Kthim i mjeteve	-	-	170.00€	50.00€	220.00€
24	Afatizimi i mjeteve	-	-	100,000.00	-	100,000.00€
I. GJITHSEJ SHPENZIMET – në llogarinë kryesore të OSK-së:						137,181.65€

2 - SHPENZIMET NË LLOGARINË E FONDIT PËR SOLIDARITET

2-SHPENZIMET		TM-1	TM-2	TM-3	TM-4	SHPENZIM ET TM1:TM4
2.1.	Përkrahje financiare nga fondi për Solidaritet i OSK-së	4,000.00€	-	1,000.00€	2,000.00€	7,000.00€
2.2.	Provizione bankare	4.60€	3.00€	3.80€	3.00€	14.40€

Bartja e mjeteve në llog. kryesore	50.00€	-	395.83€	150.00€	595.83€
II. GJITHSEJ SHPENZIMET – në llogarinë e fondit për Solidaritetit të OSK-së:					7,610.23€

Gjithsej Shpenzimet nga: Llogaria kryesore + Llogaria e Solidaritetit (I+II) **144,791.88€**

1 – Llogaria kryesore bankare e OSK-së	2- Nënlogaria e Fondit për Solidaritet
SALDO ME DATË: 01.01.2023155,579.67€	SALDO ME DATË: 01.01.20237,287.31€
GJITHSEJ TË HYRAT..... 201,486.66€	GJITHSEJ TË HYRAT 4,965.93€
GJITHSEJ SALDO + TË HYRAT.....357,066.33€	GJITHSEJ SALDO + TË HYRAT.....12,253.24€
GJITHSEJ SHPENZIMET.....(137,181.65€)	GJITHSEJ SHPENZIMET.....(7,610.23€)
AFATIZIMI I MJETEVE..... (100,000.00€)	SALDO ME DATË: 31.03.2022 4,463.01€
SALDO ME DATË 31.12.2023 119,884.68€	
	1-Gjithsej të hyrat..... 4,965.93€
1-Gjithsej të hyrat..... 201,486.66€	2-Gjithsej Shpenzimet.....(7,610.23€)
2-Gjithsej Shpenzimet.....(137,181.65€)	
3-Bilanc pozitiv financiar.....64,305.01€	